

## Lënia e shtetësisë

Lënia e shtetësisë shqiptare bëhet me dekret të Presidentit të Republikës, kurse përpunimi i kërkesës për lënien e shtetësisë bëhet nga Ministria e Brendshme.

Shtetasi që dëshiron të heqë dorë nga shtetësia shqiptare duhet detyrimisht të ketë siguruar mëparë premtimin e shtetësisë austriake.

Aplikimi për heqjen dorë nga shtetësia shqiptare është individual, pra bëhet nga vetë personi që kërkon të heqë shtetësinë ose nga një personi afërm i autorizuar me prokurë.

Përrjashtim lidhur me këtë bëjnë të miturit deri në moshën 14 vjeç, për të cilët aplikojnë prindërit tyre.

Kurse për fëmijët e moshës 14 deri 18 vjeç, aplikimi është individual, por duhet shoqëruar ngadeklaratat noteriale aprovuese të dy prindërve.

Në rast se fëmija ka vetëm një prind ose ka një kujdestar, aplikimit i bashkëlidhen dokumentet që konfirmojnë kujdestarinë mbi fëmijën.

### Autoritetet që pranojnë kërkesën për lënie shtetësie

Kërkesa për lënien e shtetësisë mund të bëhet direkt në komisariatit e policisë në zonën ku figuron i regjistruar shtetasi, por edhe indirekt nëpërmjet Ambasadës nëpërmjet portalit e-albania.al ku duhet kërkuar shërbimi “Aplikim për lënie shtetësie shqiptare”.

### Kërkesa për heqjen dorë nga shtetësia shqiptare duhet të përmbajë

#### dokumentet emëposhtme:

1. Kërkesë e shtetasit shqiptar drejtuar Presidentit të Republikës së Shqipërisë, me anë të së cilës paraqiten arsyet e kërkesës për heqjen dorë nga shtetësia shqiptare. Kërkesa duhet të përmbajë identitetin e plotët të kërkuarit (emër, mbiemër, datëlindje, vendlindje, shtetësi), adresën e saktë të vendbanimit të tij të përhershëm dhe adresën (si dhenr. tel.) ku pret informim për ecurinë e kërkesës së tij. Kërkesa nënshkruhet me emër, mbiemër e firmë nga kërkuari;
2. Premtimi i shtetësisë austriake (Bescheid) nga zyra kompetente austriake (Landesregierung);
3. Dokument që vërteton vendbanimin në Austri (Meldebestätigung);
4. Çertifikatë lindje shqiptare;
5. Çertifikatë familjare shqiptare;
6. Dëshmi penaliteti nga Ministria e Drejtësisë në Shqipëri;
7. Vërtetim nga Gjykata e Rrethit në Shqipëri, që nuk ka procese gjyqimor të hapura;
8. Vërtetim nga Prokuroria e Rrethit në Shqipëri, që nuk ka hetime në proces;
9. Vërtetim nga Zyra e Përmbartimit në Shqipëri, që nuk ka detyrime financiare;
10. Vërtetim nga Kryetari i Njësisë Administrative në Shqipëri për regjistrimin si banor i njësisë;
11. Çertifikatë martesë e aplikantit, nëse është i martuar, e marrë në vendin ku është lidhur martesë;
12. Për fëmijët 14 deri 18 vjeç duhet një deklaratë noteriale e të dy prindërve, ku të shprehet pëlqimi i tyre për heqjen dorë nga shtetësia shqiptare. Deklarata mund të bëhet në Ambasadë, tek noteri austriak ose tek noteri shqiptar. Deklarata e bërë tek noteri austriak duhet të pajiset me vulë Apostile.

#### Udhëzime

- Dokumentet e pikave 4,5, 6, 7, 8, 9, 10, (dhe 11 nëse martesë është lidhur në Shqipëri) sigurohen nga nëpunësit e ambasadës.
- Dokumentet e përmendura në pikat 2, 3 (dhe 11 nëse martesë është lidhur në Austri) merren nga autoritetet austriake. Ato duhet patjetër të pajisen me vulë Apostile dhe të jenë të përkthyer në shqip nga përkthyes të njohur nga shteti austriak.

- Kur martesë është bërë në një vend të tretë, dokumenti i pikës 11 duhet marrë nga autoritetet e atij vendi, të pajiset me vulë Apostile ose të legalizohet nga Ambasada jonë atje (jo nga Ambasada në Vjenë), të përkthehet në shqip dhe të noterizohet nga noteri shqiptar;
- Fëmijët e lindur jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë duhet të jenë paraprakisht të regjistruar në Zyrën e Gjendjes Civile në Shqipëri;
- Të gjitha dokumentet duhet të jenë në origjinal;
- Në rast se kërkesa për lënien e shtetësisë bëhet nëpërmjet Ambasadës, duhet që në Ambasadë të dorëzohet komplet dokumentacioni i përmendur më lart, përfshirë dokumentet që merren nga i interesuari në zyrat në Shqipëri;
- Për shtetasit e martuar, Dëshmia e penalitetit dhe të gjitha Vërtetimet e marra nga zyrat përkatëse në Shqipëri duhet të përmbajnë të dy mbiemrat e aplikantes/it.
- Si afat vlefshmërie i dokumentit të premtimit të shtetësisë austriake pranohet afati kohor që përmban vetë dokumenti. Përsa i përket dokumenteve të tjera:
  1. Kur kërkesa për lënien e shtetësisë bëhet direkt në komisarjat nga vetë shtetasi, dokumentet nuk duhet të jenë më të vjetra se tre muaj nga data e lëshimit;
  2. Kur kërkesa bëhet nëpërmjet Ambasadës, dokumentet nuk duhet të jenë më të vjetra se tre muaj nga data e lëshimit deri në datën e pranimit të dokumenteve nga Ambasada;
- Dokumentet duhet të jenë në harmoni të plotë me njëri-tjetrin dhe pa gabime e korrigjime;
- Kohëzgjatja e procedurës varion 6 - 12 muaj.

### **Tarifa për veprimet me shtetësinë nëpërmjet Ambasadës**

Nëse kërkesa për lënien e shtetësisë bëhet nëpërmjet Ambasadës, aplikuesi bën pagesën prej 30€ në llogarinë e Ambasadës për shërbimet konsullore për çdo person aplikant dhe e dorëzon dëshminë e kësaj pagese në Ambasadë së bashku me dokumentet e tjera. Tarifa e pagesës për Deklaratat Noteriale për heqjen e shtetësisë për fëmijët deri 18 vjeç është 20€. Pagesa është e pakthyeshme.

### **Përfundimi i procedurës**

Zyra e Presidencës e përcjell si rregull konfirmimin e dekretit për lënien e shtetësisë drejtpërdrejt tek i interesuari në adresën e dhënë prej tij. Ky veprim shënon edhe përfundimin e procedurës.

Lidhur me konfirmimin e lënies së shtetësisë, nga autoritetet austriake shpesh kërkohet një vërtetim nga Ambasada. Për këtë duhet që të bëhet kërkesa në Ambasadë, duke paraqitur dokumentin e marrë nga Zyra e Presidencës. Ky vërtetim ka një tarifë konsullore prej 30€, shumë e cila duhet të derdhet paraprakisht në llogarinë e Ambasadës për shërbimet konsullore. Zarfë që dërgohet në Ambasadë duhet të përmbajë: Dokumentin e Zyrës së Presidencës, dëshminë e pagesës 30€ dhe një zarf me kthim të paguar dhe me adresën e marrësit në të.